



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 160-3F350 /2020

Klinë, me 24.12.2020

*Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare me 04.06.2008, nr.28/2010, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh masat per mbrojtje nga COVID-19 dhe prishjen e rendit dhe qetësisë publike në prag të festave të fundvitit, kryetari i Komunës së Klinës, më dt.24.12.2020, merr **këtë**:*

V E N D I M

Për

Ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike

1. **NDALOHET**, ndezja dhe përdorimi i fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike në hapësirat publike, përkatësisht tregje, rruge, sheshe dhe vende tjera publike, si dhe organizimi i ceremonive festive për fundvit.
2. Ndaj personave të cilët veprojnë në kundërshtim më këtë ndalese, shqiptohet gjoba në shumën prej **100 €** (njëqind euro), si dhe do të ndërmerren masat tjera sanksionuese në përputhje më dispozitat e Ligjit për Përdorim Civil të Eksploziveve, nr.04/L-022 si dhe Ligjit për Kundërvajtjet, nr.05/L-087, si dhe aktet tjera nënligjore.
3. **OBLIGOHET**, Drejtoria e Inspektoratit, që në bashkëpunim më Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Klinë, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme ndaj shkelësve eventual të kësaj ndalese.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Inspektoratit;
- Stacioni Policor në Klinë;
- kopje ne tabelën e shpalljeve
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.

